



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 747 Prot.

Tiranë, më 08.06 2018

VENDIM Nr. 113, datë 14.05.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.5 të datës 14.05.2018, pasi shqyrtoi kërkesën e ALUIZNI-it Vlorë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Banesë një kat ndërtuar mbi vendstrehim" të Znj. Eli Pandeli Hoxha, Zona Kadastrale 8601, Lagjia "Hajro Çakërrri", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e ALUIZNI-it Vlorë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Banesë një kat ndërtuar mbi vendstrehim" të Znj. Eli Pandeli Hoxha, Zona Kadastrale 8601, Lagjia "Hajro Çakërrri", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës me kushtin:
 - Të respektohen kriteret e projektit "Rikualifikimi në zonën e mbrojtur urbane pranë qendrës së qytetit të Vlorës: Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve të kulturës në këtë zonë dhe rikonstrukcioni i objekteve të tjerë", Vlorë, me subjekt aplikues AADF, studio projektuese "Atelier 4", pasi pozicioni i objektit për legalizim përfshihet në zonën e studimit A të këtij projekti.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETARI I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al